

VENDIM
Nr. 728, datë 12.12.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 95, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KËRCËNIMIT TË
RREZIKUT PËR JETËN DHE PAJISJEN ME AUTORIZIM TË POSAÇËM
PËR MBAJTJE ARME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 95, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Policia e Shtetit të krijojë komision për vlerësimin e rrezikut të personave, për shkak të aktivitetit shtetëror që kanë pasur ose kanë aktualisht, si dhe për shkak të rrethanave personale të veçanta, me këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| a) Drejtor i Departamentit për Sigurinë Publike | kryetar; |
| b) Drejtor i Drejtorisë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë | anëtar; |
| c) Drejtor i Drejtorisë së Rendit Publik | anëtar; |
| ç) Shef i sektorit të ndihmës juridike | anëtar; |
| d) Shef i sektorit të shërbimeve të të tretëve | anëtar.”. |

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama